ALBKOS SAFETY SH.P.K.
NRB 811440908 | TVSH 330455958
Rr. e Pejës 26 ▪ 12000 Fushë Kosovë ▪ Republika e Kosovës
Tel./Fax: +383 (38) 534 653, GSM: +383 (44) 504 605
Email: info@albkossafety.com
www.albkossafety.com

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: KOMUNA E PODUJEVËS

Për Aktivitetin e Prokurimit: 615-23-5360-1-3-6

Sa i përket tenderit për: Furnizim dhe servisim i aparateve për fikjen e zjarrit

ANKESË

1. IDENTIFIKIMI I ANKUESIT*

ALBKOS SAFETY SH.P.K.
(shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr. e Pejës, nr. 26
(Adresa)

Fushë Kosovë
(Vendi)

12000
(Kodi Postar)

044 504 605
(Numri i telefonit)

038 534 653
(Numri i faksit)

Emin Mirena
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

info@albkossafety.com
(adresa elektronike)

06.07.2023
(data e parashtrimit të ankesës)

(nënshkrimi dhe vula)

*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

2. TË DHËNAT MBI AKTIVITETIN E PROKURIMIT

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

01	Njoftim për kontratë:	26.05.2023
	Afatet kohore	
	Sqarimi | dorëzimi i dosjes së tenderit:	02.06.2023 | 06.06.2023, në 13:00
	Kriter për dhënie të kontratës:	Çmimi më i ulët për njësi me poentim
	Vlera e parashikuar e kontratës:	8.000,00 EUR Kontratë kornizë 24 muaj
02	Hapja e tenderëve:	06.06.2023
03	B08 Njoftim për dhënie të kontratës:	20.06.2023
04	Kërkesë për qasje në dok e OE fitues:	21.06.2023
05	Pranimi i dokumenteve të OE fitues:	22.06.2023
06	Kërkesë për rishqyrtim	23.06.2023

3. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po [ ] **JO** [X]

Nuk kemi marrë pjesë në hapje të këtij aktiviteti të prokurimit.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po [x] **JO** [ ]

Më 21.06.2023 AK ka njoftuar se propozuar për të shpërblyer me kontratë AK PROGLOBAL SH.P.K.

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [x] **JO** [ ]

Me datën 23.06.2023, në përputhje me nenin 108/A dhe brenda afateve kohore të përcaktuara me LPP kemi bërë kërkesë për rishqyrtim, por deri më sot, më 06.07.2023 nuk kemi marrë asnjë përgjigje nga AK.

Provë: Kërkesa për ri-shqyritm, në 23.06.2023
Dokumenti: 07_Kërkesë_për_qasje_21.06.2023.pdf

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 108/A
Neni1
Neni 6
Neni 7
Neni 8
Neni 52
Neni 59
Neni 66
Neni 108/A
Neni 97- Rregullores për prokurimin publik nr. 01.11.2022

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

Në tenderin e publikuar më 02.06.2023, nga AK KK Podujevë, për "Furnizim dhe servisim i aparateve për fikjen e zjarrit", më datën 06.06.2023, kanë marrë pjesë dy OE:

1. Albkos Safety Sh.p.k. me çmim (për njësi të poentuar) 83,04 EUR dhe
2. Proglobal Sh.p.k. me çmim (për njësi të poentuar) 24,32 EUR

Provë 1: Procesverbali i hapjes, më 06.06.2023
Dokumenti: 03_Procesverbali_06.06.2023.pdf

Më datën 21.06.2023, AK ja njoftuar se ka propozuar për ta shpërblyer me kotratë OE Proglobal Sh.p.k..

Provë 2: Vendimi i AK, më 21.06.2023
Dokumenti: 05_Vendimi_i_AK_21.06.2023.pdf

Duke qenë se kriteri i vlerësimit i përcaktuar nga AK është bërë në kundërshtim me LPP-në, dhe për shkak të përvojave jo të mira të deritanishme me këtë kriter vlerësimi, e dëshmuar si një mundësi e pastër manipulimi, më datën 21.06.2023 kemi kërkuar qasje në dokumentet e OE fitues, gjë e cila na është lejuar.

Provë 3: Kërkesë për qasje, më 21.06.2023
Dokumenti: 07_Kërkesë_për_qasje_21.06.2023.pdf

Pas pranimit dha një analize të hollësishme të dokumenteve të OE fitues, kemi konstatuar se OE në shumicën e zërave ka oferuar me çmime jo të tregut, të cilat në shumicën e rasteve janë të karakterit abuziv, andaj më 23.06.2023 kemi bërë kërkesë për rishqyrtim, me përmbajtjen në vijim:

Nuk pajtohemi me njoftimin për dhënie të kontratës OE PROGLOBAL SH.P.K., duke qenë se OE në fjalë nuk ka dhënë çmime tregu, por çmime kryesisht abuzive të cilat do të sqarojmë në vijim.

SQARIM HYRËS

Përcaktimi i kriterit "çmimi më i ulët për njësi me poentim", është në kundërshtim ne LPP, pasi që ky kriter zbatohet vetëm në ato raste kur sasitë nuk dihen, gjë që nuk është rasti me këtë aktivitet të prokurimit, për arsyet në vijim:

i. Sipas UA nr. 17/2017 për Testimin dhe Servisimin e Aparateve për Fikje të Zjarrit, (a) kontrolli i rregullt i aparateve për shuarjen e zjarrit kryhet të paktën 1 x në çdo muaj, kurse (b) servisimi periodik të paktën 1 x në çdo gjashtë muaj.

   a) Sipas paragrafit 1 të nenit 7 – Kontrolli i rregullt, kryhet nga pronari ose shfrytëzuesi i pajisjeve

   b) Sipas paragrafit paragrafi 2 të nenit 9 – Procesi i servisimit periodik, kryhet nga servisi i autorizuar nga AME.

ii. Sipas UA Nr 24/2012 për Rrjetin e Hidrantëve për Fikjen e Zjarrit, testimi i hidrantëve duhet të bëhet të paktën 1x në vit (Neni 22 Testimi i rrjetit të hidrantëve).

iii. Pas çdo servisimi, servisi i autorizuar përpilon raportin dhe jep rekomandimet për ndërrimin eventual të ndonjë pajisjeje, kurse nevojat për ndërrimin e pjesëve rezervë është minimale (varësisht nga industria 1 – 5%).

   Në bazë të këtyre raporteve bëhet faturimi dhe pagesa për shërbimin e kryer dhe sasitë dihen saktë.

iv. Planifikimi me pajise të reja, që është detyrim ligjor sipas nenit 8 të LPP, mund të bëhet bazuar në UA nr. 17/2017 për Testimin dhe Servisimin e Aparateve për Fikje të Zjarrit, sipas të cilit mund të përcaktohet saktë numri i nevojshëm i aparateve për shuarjen e zjarrit (duke u bazuar në shkallën e rrezikshmërisë dhe sipërfaqen e objektit dhe ngjashëm me këtë vlen edhe për hidrantë.

Në anën tjetër është dëshmuar që përcaktimi i këtij kriteri nuk është i përshtatshëm në rastin kur dihen sasitë, si në rastin aktual, por zbatohet vetëm për qëllime manipulimi, sikurse në këtë rast, siç do ta dëshmojmë në vijim:

Në tabelën në vijim, janë paraqitur çmimet e furnizimit me aparate të reja, të OE PROGLOBAL SH.P.K. i propozuar për t'u shpërblyer me kontratë.

PARAMASA DHE PARALLOGARIA FURNIZIM DHE SERVISIMI I APARATE PER FIKJEN E ZJARRIT NË KOMUNËN						Peshimi i pozicioneve
	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Çmimi me TVSH	Totali me TVSH	%
A						**A) 25% e pikëve për vlerësim**
1	Aparat per fikjen e zjarrit me pluhur ABC 1 kg	copë	1	4,40	€ 4,40	€ 1,10
2	Aparat per fikjen e zjarrit me pluhur ABC 2 kg	copë	1	5,20	€ 5,20	€ 1,30
3	Aparat per fikjen e zjarrit me pluhur ABC 3 kg	copë	1	6,10	€ 6,10	€ 1,53
4	Aparat per fikjen e zjarrit me pluhur ABC 6 kg	copë	1	10,80	€ 10,80	€ 2,70
5	Aparat per fikjen e zjarrit me pluhur ABC 9 kg	copë	1	11,10	€ 11,10	€ 2,78
6	Aparat per fikjen e zjarrit me CO2-5 kg	copë	1	11,30	€ 11,30	€ 2,83
	TOTALI A				**€ 48,90**	**€ 12,23**

Të gjitha çmimet e mësipërme janë më të ulëta se çmimi i furnizimit, e nëse krahasohen me çmime tregu atëherë ato janë disa herë më të ulëta.

Ky është një indikator i qartë se OE mund të ketë pasur informacion nga AK, se nuk do të ketë furnizim me aparate të reja, përndryshe OE nuk do të kishte ofertuar me çmime më të ulëta se sa çmimi i tregut.

Le t'i krahasojmë çmimet e shitjes së vet këtij OE në rastin kur dihen sasitë, siç është rasti me faturën nr. 07/2022 të datës 10.04.2022, lëshuar HQ-G4:

- Çmimi i shitjes së aparatit me pluhur prej 6kg (në poz. 4), prej 10,80 (9,15 pa TVSH), është rreth **4,14 herë më i ulët se çmimi i shitjes prej 37,91 EUR** (i OE pas zbritjes prej 5%, pa TVSH), klientit HQ-G4.
- Çmimi i shitjes së aparatit me pluhur prej 9kg (në poz. 5), prej 11,10 (9,41 pa TVSH), është rreth **5,71 herë më i ulët se çmimi i shitjes prej 53,68 EUR** (i OE pas zbritjes prej 5%, pa TVSH), klientit HQ-G4.

- Çmimi i shitjes së aparatit me pluhur prej CO2-5kg (në poz. 6), prej 11,30 (9,58 pa TVSH), është rreth **9,77 herë më i ulët se çmimi i shitjes prej 94,58 EUR** (i OE pas zbritjes prej 5%, pa TVSH), klientit HQ-G4.

Provë: Fatura nr. 07/2022 të datës 10.04.2022, lëshuar HQ-G4

Në tabelën për kontrollimin dhe servisimin e aparateve zjarrfikëse, OE ka dhënë çmimet në vijim:

	Tabela B – KONTROLLA DHE SERVISIMI I APARATEVE ZJARRFIKES					**B) 45% I pikëve për vlerësim**
Nr.	PËRSHKRIMI	Njësia	Sasia			
1	Kontrolla dhe Servisimi te aparatit zjarrfikes P-1kg	copë	1	0,11	€ 0,11	€ 0,05
2	Kontrolla dhe Servisimi te aparatit zjarrfikes P-2kg	copë	1	0,13	€ 0,13	€ 0,06
3	Kontrolla dhe Servisimi te aparatit zjarrfikes P-3kg	copë	1	0,15	€ 0,15	€ 0,07
4	**Kontrolla dhe Servisimi te aparatit zjarrfikes P-6kg**	**copë**	**1**	**9,90**	**€ 9,90**	**€ 4,46**
5	**Kontrolla dhe Servisimi te aparatit zjarrfikes P-9kg**	**copë**	**1**	**6,40**	**€ 6,40**	**€ 2,88**
6	Kontrolla dhe Servisimi te aparatit zjarrfikes P-12kg	cope	1	0,21	€ 0,21	€ 0,09
7	Kontrolla dhe Servisimi te aparatit zjarrfikes P-50kg	copë	1	0,16	€ 0,16	€ 0,07
8	Kontrolla dhe Servisimi te aparatit zjarrfikes CO2-5kg	copë	1	0,17	€ 0,17	€ 0,08
9	Kontrolla dhe Servisimi i Hidrantit te murit	copë	1	0,14	€ 0,14	€ 0,06
	TOTALI B				**€ 17,37**	**€ 7,82**

Vëni re çmimet e artikujve nën poz. 4 – 5, që janë çmimet e servisimit me çmimet nën pozicionet 4 dhe 5 të tabelës së mësipërme.

- Çmimi i kontrollës për servisim të aparatit nën poz. 4, P-6kg 2 x 9,90 (për dy servisime brenda vitit) = 19,80 EUR, ndërsa për dy vite, aq sa zgjatë kontrata do të jetë = 39,60 EUR.

  Meqenëse OE ka ofertuar me çmim prej 10,80 EUR, për furnizim me aparat të ri P-6kg, i cili ka një garanci prej 12 muajsh.

Ngjashëm me këtë vlen edhe për aparatin P-9kg, nën pozicionin 5.

Sipas UA nr. 17/2017 për Testimin dhe Servisimin e Aparateve për Fikje të Zjarrit, përkatësisht nenit 9, paragrafit 3, në momentin e vendosjes së aparatit për fikje të zjarrit në përdorim nuk është e nevojshme për të kryer servisimin periodik deri në fund të garancisë.

Duke u nisur nga ky fakt, i bie që më e leverdishme për AK do është që çdo vit të furnizohet me aparate të reja, me çmimin e ofruar nga OE i propozuar për t'u shpërblyer me kontratë, se sa të bëjë servisimin e aparateve të vjetra të cilat i ka në përdorim, pasi që do të paguante më pak dhe mbi të gjitha do të merrte aparate të reja.

Në anën tjetër, nëse krahasoni çmimet e servisimit të ofruara nga ne, do të konstatoni qe ne jemi më të lirë se OE i propozuar për t'u shpërblyer me kontratë.

Në tabelën e radhës, mund të shihni çmimet për mbushje të cilat janë po ashtu të parregullta.

	Tabela C – MBUSHJA E APARATEVE ZJARRFIKES					**C) 15% I pikëve për vlerësim**
Nr.	**PËRSHKRIMI**	Njësia	Sasia			
1	Kontrolla dhe Servisimi te aparatit zjarrfikes P-1kg	copë	1	0,07	€ 0,07	€ 0,01
2	Kontrolla dhe Servisimi te aparatit zjarrfikes P-2kg	copë	1	0,09	€ 0,09	€ 0,01
3	Kontrolla dhe Servisimi te aparatit zjarrfikes P-3kg	copë	1	0,11	€ 0,11	€ 0,02
4	Kontrolla dhe Servisimi te aparatit zjarrfikes P-6kg	copë	1	9,85	€ 9,85	€ 1,48
5	Kontrolla dhe Servisimi te aparatit zjarrfikes P-9kg	copë	1	2,34	€ 2,34	€ 0,35
6	Kontrolla dhe Servisimi te aparatit zjarrfikes P-12kg	copë	1	0,11	€ 0,11	€ 0,02
7	Kontrolla dhe Servisimi te aparatit zjarrfikes P-50kg	copë	1	0,13	€ 0,13	€ 0,02
8	Kontrolla dhe Servisimi te aparatit zjarrfikes CO2-5kg	copë	1	0,14	€ 0,14	€ 0,02
	TOTALI C				**€ 12,84**	**€ 1,93**

Kjo vjen si pasojë e përcaktimit të kriterit "çmimi më i ulët për njësi me poentim", siç shihet edhe në tabelën e radhës, me çrast OE ka dhënë çmime ekstreme të larta në artikujt që me siguri do të mund të faturohen kurse çmime ekstremisht të ulëta tek artikujt që janë të karakterit fiktiv dhe që nuk do të porositen.

	Tabela D – PJESE PER APARATE ZJARRFIKES DHE HIDRANTE					D) 15% I pikëve për vlerësim
Nr.	PËRSHKRIMI	Njësia	Sasia			
1	Gyp hidranti 15m / 52mm	copë	1	1,13	€ 1,13	€ 0,17
2	Kuti hidranti muri e zbrazët	copë	1	1,34	€ 1,34	€ 0,20
3	Fiskaja e Aluminit me ndërprerje dhe lidhëse 52mm	copë	1	1,22	€ 1,22	€ 0,18
4	Ventil këndor 2"	copë	1	1,14	€ 1,14	€ 0,17
5	Shenja emergjente dimenzioni 25x22 cm	copë	1	1,45	€ 1,45	€ 0,22
6	Mbajtëse mobile e Aparateve zjarrfikëse për tipin P-6,9 per	copë	1	0,23	€ 0,23	€ 0,03
7	Mbajtëse mobile e Aparateve zjarrfikëse për tipin CO2-5 për plato	copë	1	0,23	€ 0,23	€ 0,03
8	Siguresa me unazë për AKZ	copë	1	1,98	€ 1,98	€ 0,30
9	Valvula me manometër per AKZ tip P-1,2,3	copë	1	0,11	€ 0,11	€ 0,02
10	Valvula me manometër për AKZ tip P-6,9	copë	1	1,45	€ 1,45	€ 0,22
11	Etiketa me udhezim perdorimi	copë	1	2,95	€ 2,95	€ 0,44
12	Gype gome me pluhur hedhës P-6,9	copë	1	0,13	€ 0,13	€ 0,02
13	Bllomba per Aparate zjarrfikes	copë	1	1,94	€ 1,94	€ 0,29
14	Gype gome me gas hedhës per tip CO2-5	copë	1	0,21	€ 0,21	€ 0,03
15	Valvula CO2-5	copë	1	0,14	€ 0,14	€ 0,02
	Totali D				**€ 15,65**	**€ 2,35**

Imagjinoni çmimi i një gypi zjarrfikës është për gati 3x më i ulët se një etiketë udhëzimi për përdorimin e një aparati, ose për 1,9x më i ulët se një bllombë aparati.

Përfundim:

1. AK ka përdorur kriter të gabuar vlerësimi, duke përcaktuar "çmimi më i ulët për njësi me poentim", i cili zbatohet vetëm në ato raste kur nuk dihen sasitë.
2. Një numër i madh i artikujve i paraparë me këtë tender është i karakterit fiktiv, gjë që mund të konstatohet nga çmimet e ofruara nga OE i propozuar për t'u shpërblyer me kontratë, i cili ka pasur kontratën e fundit për servisimin e aparateve për shuarjen e zjarrit me këtë AK dhe e di saktë se cilët artikuj kërkohen e cilët jo.

   AK është dashur të veprojë në përputhje me Nenin 8 të LPP, të planifikojë me kohë pajisjet me të cilat ka pasur nevojë të furnizohet dhe të jep sasitë indikative, kurse sa i përket pajisjeve që duhet servisuar, ato dihen 100% (bazuar në faturimin e fundit nga OE).
3. Nëse i krahasoni çmimet e servisimit të OE të propozuar për ta shpërblyer me kontratë, me çmimet e ofruar nga ne, atëherë çmimi ynë është më i ulët, andaj fitues është dashur të shpallemi ne.

Kërkojmë nga AK, që të anuloj njoftimin për dhënie të kontratës OE Proglobal, të kthejë lëndën në rivelerësim dhe të na shpallë fitues si OE i vetëm i përgjegjshëm, në të kundërtën do të ushtrojmë ankesë pranë OSHP-se.

Provë 4: Kërkesë për rishqyrtim, 23.06.2023
Dokumenti: 06_KK_Podujevë_Kerkese_per_rishqyrtim_23.06.2023.pdf

Megjithatë, AK nuk është përgjigjur në kërkesën tonë as sot, kur kanë kaluar rreth 13 ditë nga kërkesa jonë për rishqyrtim më 23.06.2023.

y veprim apo mosveprim i AK, sipas nenit 97, përkatësisht paragrafit e të i Rregullores për prokurimin publik nr. 01.11.2022, përbën shkelje të rëndë.

Po ashtu, sipas kësaj rregullore, edhe përcaktimi i kritereve të gabuara përbën shkeljet të rëndë, siç thuhet në

paragrafin në vijim:

d. Mos respektimi apo shkelja e parimeve themelore të prokurimit publik të përcaktuar me LPP. Shkeljet e parimeve themelore përfshijnë, **vendosjen e kritereve** apo dëshmive jo në përputhje me LPP apo përshtatjen për një ofertues të caktuar, trajtim jo të barabartë të ofertuesve gjatë ushtrimit të procedurave të prokurimit, përveç specifikimit teknik që bie në përgjegjësinë e Njësisë së kërkesës.

Për këtë aktivitet të prokurimit nuk është dashur të përcaktohet si kriter vlerësimi **"çmimi për njësi me poentim",** me arsyetimin, siç ndodhë zakonisht **"nuk i dimë sasitë",** sepse ato dihen saktë, gjë e cila mund të dëshmohet edhe përmes ofertës së OE PROGLOBAL SH.P.K. i cili është shpallur fitues, i cili i ka pasur të gjitha informatat e sakta duke qenë se së fundmi ka pasur një kontratë me këtë AK për servisimin e apartateve për shuarjen zjarrit.

Mjafton të bëni një krahasim të çmimit të artikullit p.sh. nën pozicionin 1. Gyp hidranti me gjatësi prej 15m dhe diametër prej 5,2cm, me çmim prej 1,13 EUR me artikullin nën pozcionin 13. Bllombë për aparat zjarrfikës, me diametër prej 5mm, me çmim prej 1,95 EUR.

1. Gyp hidranti me gjatësi prej 15m dhe diametër prej 5,2cm, me çmim prej **1,13 EUR**	13. Pllombë (dia. 5mm) **1,94 EUR**

Lidhur me këtë kriter vlerësimi, OSHP tashmë ka marrë disa vendime duke e cilësuar si të palejueshëm, ndërsa rasti i fundit është vendimi i OSHP nr. **2023-0281**!

Përfundim

Ky aktivitet i prokurimit, në çdo fazë të tij është udhëhequr në mënyrë të kundërligjshme, dhe mendoj se në këtë fazë është e pamundur të riparohet ndonjë gjë në mënyrë që përmbush kriteret minimale ligjore, andaj jemi të mendimit se duhet anuluar, në mënyrë që krijohen mundësi shpenzimi optimal të fondeve publike dhe kushte të barabarta pjesëmarrjeje për të gjithë OE e interesuar.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Dëme të konsiderueshme materiale të shkaktuara si rezultat i mos realizimit të fitimit të pritur, por edhe dëmet të tjera si pasojë e shpenzimeve të panevojshme shtesë në përgatitjen e kërkesave për informata, kërkesave për rishqyrtim dhe kësaj ankese, për të cilat ka qenë i nevojshëm angazhimi burimeve njerëzore duke shkaktuar kosto shtesë.

9. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura